

REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTARSTVOZA REGIONALNI RAZVOJ
MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
DALESE / IZLAZNA / OUTGOING

Nr./Br./No 376
Nr.faq / Br.str./No.pag 13 / 05 / 2024
Data / Datum / Date 13 / 05 / 2024
PRISHTINE · PRISTINA · PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvoza Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal
2020-2030

(Periudha: Janar 2023-Dhjetor 2023)

Prishtinë, 2024

Hyrje

Strategjia për Zhvillim Rajonal (2020-2030) është dokumenti themelor që përcakton kuadrin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për arritjen e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm të rajoneve zhvillimore, me qëllim të tejkalimit të dallimeve/pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në kontekst të zbatimit të politikës evropiane të kohezionit dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe gjithëpërfshirëse.

Strategjia për Zhvillimit Rajonal (2020-2030) përcakton qëllimet dhe prioritetet afatgjate 10-vjeçare të politikës së zhvillimit rajonal, që mundëson koordinimin e politikave sektoriale në territorin përkatës të rajonit zhvillimor dhe mbështetë sinkronizmin mes tyre. Strategjia ka një rol të rëndësishëm për arritjen e përputhshmërisë dhe sinergjisë ndërmjet qëllimeve dhe prioriteve të politikës së zhvillimit rajonal dhe politikave dhe strategjive sektoriale, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e balancuar të rajoneve zhvillimore.

Strategjia për zhvillim rajonal, përcakton politikat prioritare të Qeverisë, në nivel afatmesëm dhe jep orientimet strategjike zhvillimore afatgjate.

Me qëllim të monitorimit të implementimit të strategjisë për Zhvillim Rajonal, Ministria e Zhvillimit Rajonal, në bazë periodike harton raporte monitoruese për implementim të aktiviteteve sektoriale, aktiviteteve të komunave, OJQ-ve dhe aktiviteteve të MZHR, për të pasqyruar nivelin e realizimit dhe përmbushjes së detyrimeve sektoriale që dalin nga kjo strategji.

Raporti i shërben Qeverisë për të parë nivelin e zbatimit të strategjisë si dhe për të ri-orientuar nëse është e nevojshme politikat zhvillimore, i shërben institucioneve të cilat kanë përgjegjësi konkrete në zbatimin e aktiviteteve të kësaj strategjie, organizatave jo qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe të gjitha palëve tjera të interesuara, për të parë progresin e arritur nga fusha e zhvillimit rajonal, si dhe për orientimet programore për periudhën e ardhshme sa i përket zhvillimit rajonal.

MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MONITORIM

Me qëllim të vendosjes së një mekanizmi monitorues, Ministria e Zhvillimit Rajonal, në cilësinë e institucionit përgjegjës për të monitoruar implementimin e strategjisë së zhvillimit rajonal, përmes planit të veprimit, ka përcaktuar aktivitetet dhe detyra konkrete, me afate të caktuara dhe me indikatorët përkatës, me qëllim të implementimit të strategjisë për zhvillimin rajonal. Meqenëse strategjia për zhvillim rajonal, është strategji multi-sektoriale, janë përcaktuar institucionet përgjegjëse, të cilat mbështesin Minsitrinë e Zhvillimit Rajonal, në arritjen e objektivave të strategjisë, të vendosura nga Qeveria. Poashtu, me qëllim të pasqyrimin të aktiviteteve për arritjen e objektivave si dhe realizimin e planit të implementimit të Strategjisë për Zhvillim Rajonal, Ministria për Zhvillim Rajonal harton raporte në baza periodike për të evidentuar progresin dhe sfidat në procesin e implementimit të strategjisë.

MZHR në përputhje me detyrimet e saj që përcaktojnë mandatin e saj, në mbështetje të UN-HABITAT projektit për shërbime të qëndrueshme komunale) ka koordinuar procesin e krijimit të mekanizmit monitorues të implementimit të strategjisë, me ç'rast janë evidentuar përgjegjësitë sektoriale të secilit institucion përgjegjës, apo mbështetës në nivelin qendror, komunave dhe shoqërisë civile.

Prandaj, me qëllim të evidencës së progresit për realizimin e aktiviteteve që dalin nga strategjia ka hartuar raportin 1 vjeçar të implementimit të strategjisë, për vitin 2023. Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i aktiviteteve dhe rezultateve të arritura nga kjo strategji si dhe evidentimin e sfidave dhe hapave konkret për adresimin e tyre, me qëllim të arritjes së synimeve të përcaktuara nga Qeveria, për avancimin e zhvillimit rajonal.

Me qëllim të vendosjes së një mekanizmi ndër-sektorial për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal, MZHR me vendim nr. 1197 ka themeluar grupin ndër-sektorial dhe vendimin nr.63 të datës 21.02.2024, të cilët janë koordinatorët e procesit të implementimit të strategjisë për zhvillim rajonal, nën udhëheqjen e MZHR-së.

Në bazë të objektivave të caktuara dhe synimeve për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2030, grupi ndër-sektorial për zbatimin e strategjisë është në përbërëje të institucioneve, si vijon:

- Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Zyra e Kryeministrit - Zyra për Planifikim Strategjik, Departamenti për Asistencë Zhvillimore;
- Ministria e Financave Punës dhe Trasnfereve;
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Ministria për Komunitet dhe Kthim;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Veri"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Jug"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Qendër"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Lindje"
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Perëndim"
- Përfaqësues nga Shoqëria Civile;
- Përfaqësues nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtar;

Grupi Punues takohet në baza të rregullta dhe raporton në bazë periodike, sipas kërkesave të MZHR.

LISTA E SHKURTESAVE

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ZKM	Zyra e Kryeministrit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPHI	Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ME	Ministria e Ekonomisë
MKK	Ministria për Komunitet dhe Kthim
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AZHR	Agjension për Zhvillimor Rajonal

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia për Zhvillim Rajonal ka gjithsej tri objektiva:

Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal;

Objektivi Strategjik: 2. Zhvillimi rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale;

Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.

Në kuadër të objektivit 1, me qëllim të realizimit të aktiviteteve konkrete, janë parashikuar dy objektiva specifike, si vijon:

Objektivi Specifik: 1.1 Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Objektivi Specifik: 1.2 Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.

Në objektivin 2, janë parashikuar edhe 4 objektiva specifike, si vijon:

Objektivi Specifik: 2.1 Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve;

Objektivi Specifik: 2.2 Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Objektiv Specifik: 2.3 Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Objektivi Specifik: 2.4 Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonat përmes programeve trans nacionale.

Në objektivin 3, janë parashikuar edhe 3 objektiva specifike:

Objektivi Specifik: 3.1 Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;

Objektivi Specifik: 3.2 Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve;

Objektiv Specifik: 3.4 Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Ndërsa, me qëllim të evidentimit të objektivave të strategjisë, janë vendosur synimet si vijon (të pasqyruara në tabelën 1), të cilat do të monitorohen dhe do të vlerësohen nga aspekti implementimit përmes planit të veprimit dhe raporteve monitoruese:

Synimet e përcaktuara për vitin 2024, për realizimin e objektivave strategjike të strategjisë për zhvillim rajonal	Vlera bazë 2020	Synimi 2023
Kornizë ligjore e përafuar me legjislacionin e BE-së, në fushën e zhvillimit rajonal		
Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	60%
Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.	20%	100%
Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale		
Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në baze të vlerësimeve.	0%	15%
Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	17%
Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale.	0%	30%
Arritja e niveleve më të larta të produktivitetit ekonomik përmes diversifikimit, përmirësimit teknologjik dhe inovacionit.	0%	25%
Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;		
Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.	0%	45%
Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve.	0%	15%
Hartimi dhe zbatimi i politikave për promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën, produktet lokale dhe rajonale.	0%	15%
Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.	0%	10%

OBJEKTIV STRATEGJIK: 1. KOORDINIMI I POLITIKAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL;

Objektivi Specifik 1.1. - Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi -1.1.1 Hartimi dhe miratimi i kornizës ligjore për zhvillim rajonal të balancuar ;

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministritë e linjë, Mbështetja nga donatorët: GIZ")

Ligji për Zhvillim Rajonal është miratuar me datë 13.07.2023 dhe ka hyrë në fuqi me dt. 07.08.2023. Për zbatimin e këtij ligji janë parashikuar katër (4) akte nënligjore.

Gjatë vitit 2023 janë formuar Grupet Punuese për hartimin e rregulloreve si në vijim:

1. Rregullore për menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe
2. Rregullore për themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e Qendrave për zhvillim rajonal në rajonet zhvillimore.

Procesi i hartimit të këtyre rregulloreve është realizuar gjatë tri takime të Grupeve Punuese duke përfshirë edhe Punëtorinë tre ditore të organizuar nga MZHR në bashkëpunim me GIZ. Rregulloret në fjalë kanë konsumuar konsultimin paraprak dhe kanë përfunduar konsultimin publik më dt. 27.02.2024 për të vazhduar pastaj me proceduar tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2023 është hartuar dhe finalizuar edhe Rregulloreja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MZHR ndërsa Opinionet nga MFPT dhe MPB/DMZP dhe aprovimin nga ZKM e ka marrë në vitin 2024.

Veprimi- 1.1.2 Hartimi i dokumentit shpjegues të legjislacionit për zhvillim rajonal të balancuar;

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministritë e linjë, ZKM, MF, ASK")

Është themeluar grupi punues për hartimin e dokumentit shpjegues, nga MZHR është hartuar dokumenti shpjegues për politikën rajonale në Bashkimin Evropian që pasqyron zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, të inkuoruar si: objektiva, prioritetet, dhe koncepte, që ofrojnë mundësi e barabartë për zhvillim të balancuar rajonal. Dokumenti Shpjegues është miratuar në nivel të ministrisë dhe është publikuar në uebfaqë të MZHR-së¹,

Objektivi specifik 1.2. -Themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve dhe performancës rajonale;

Veprimi -1.2.1 Themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve dhe performancës rajonale;

("Institucioni Kryesor: MZHR")

DZHR/MZHR ka krijuar grupet Monitoruese /Mbikëqyrëse për të gjitha Programet e Zhvilluara nga MZHR, si dhe janë formuar grupet/komisionet vlerësuese/monitoruese për Programet e MZHR-së.

Veprimi -1.2.2 Analiza mbi vlerësimin e fushave të nevojshme për investime me impakt rajonal;

("Institucioni Kryesor: MZHR")

¹ [Ministria e Zhvillimit Rajonal \(rks.gov.net\)](http://rks.gov.net)

Janë formuar grupet punuese dhe janë në process të realizimit të dokumentit/udhëzuesit për realizimin e dokumenteve si: "Hartimin e udhëzuesit për brendimin e rajoneve zhvillimore" dhe Studimi i fizibilitetit në rajonet zhvillimore për identifikimin e investimeve strategjike me ndikim socio - ekonomik rajonal".

Veprimi -1.2.3. Zhvillimi i sistemit për matjen e performancës rajonale;
(*"Institucioni Kryesor: MZHR, Komunitat"*)

Në vitin 2023, është iniciuar procedura për lejimin e krijimit të sistemit për matjen e performances socio - ekonomike rajonale ndërsa në korrik të vitit 2023 është pranuar pëlqimi nga ASHI për të filluar me krijimin e këtij sistemi. MZHR është në proces të pregaditjes së dokumentacionit teknik të thirrjes për aplikim për realizim të krijimit të këtij sistemi.

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 2. ZHVILLIM RAJONAL I BALANCUAR DHE RAJONE TË AFTA PËR KONKURRENCË NDËR RAJONALE

Objektivi specifik 2.1 - Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioritetëve në baze të vlerësimeve.

Veprimi - 2.1.1. Krijimi i data bazës rajonale me të dhëna socio-ekonomike;
(*Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MFT, ASK*)

Është krijuar databaza rajonale me të dhëna socio-ekonomike - SPSS, sistem i cili është pilotuar me disa nga ministritë e linjes dhe është në fazë përmblylëse si pilot projekt.

Databaza me të dhënat socio - ekonomike për hartimin e analizave nga ministritë e linjes dhe akterët relevant, është duke u azhurnuar në baza të rregullta nga MZHR dhe kjo metodë e grumbullimit të të dhënave nga akterët relevant, është duke u përdorur edhe për hartimin e dokumenteve tjera me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik.

Janë realizuar trajnime të personelit

gjatë vitit 2023 ku janë trajnuar gjashtë (6) zyrtar të Ministrisë dhe planifikohet të vazhdohet edhe me trajnimin e tre (3) zyrtarëve tjerë gjatë vitit 2024.

Veprimi - 2.1.2. Identifikimi i investimeve publike nga niveli qendror sipas rajoneve zhvillimore, zbërthyer edhe sipas komunave;
(*Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MINT, MAPL*)

Gjatë vitit 2023 është përgatitur pakoja e projekteve të komunave për konferencën e donatorëve për sektorët e kërkuar ku janë grumbulluar 117 projekt propozime nga komunitat në vlerë prej 463,891,141.20 €. Në rajonin Lindje janë gjithsej 31 projekt koncepte siq janë paraqitur në Tabelë.

No	KOMUNA	PROJEKTI	BUGJETI I PERAFEF
1	Ferizaj	Rindërtimi i Kalasë së Jezercit	1,000,000.00
2	Gjilan	Liqeni i Livoqit	6,911,868 .60
3	Gjilan	Efiçienca energjetike e rrufesë publike në Gjilan	1,860,735.00
4	Gjilan	Zona Ekonomike në Gjilan	24,575,890.00
5	Hani i Elezit	Rehabilitimi i shtratit të lumit Lepenc dhe shtigjeve për ecje dhe çiklizëm rreth tij	1,500,000.00
6	Hani i Elezit	Ndërtimi i rrugës Gorancë – Krivenik	1,040,279.00
7	Kacanik	Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Gerlicë-Guri i Shpum	1,250,000.00
8	Kacanik	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës për në Luboten	753,000.00
9	Kamenica	Krijimi i shtegut për ecje në Kamenicë	550,000.00
10	Kamenica	Restaurimi i Kalasë së Kulinës	470,000.00
11	Kamenica	Zhvillimi i fshatit turistik	400,000.00
12	Kamenica	Menaxhimi i mbetjeve inerte	1,200,000.00
13	Kamenica	Rehabilitimi dhe rivitalizimi i parkut të qytetit në Kamenicë	400,000.00
14	Klllokot	Aqua park i Klllokotit	5,106,283.98
15	Klllokot	Etno Shtëpia në Vërbovc	448,856.50
16	Klllokot	Rehabilitimi i shtratit të vjetër të lumit të Moravës së Binçes	942,275.00
17	Klllokot	Ndërtimi i trotuarit dhe shtegut për biçikleta në Mogillë	484,341.20
18	Klllokot	Qendër sportive multifunkionale në Klllokot	1,883,859.17
19	Novoberde	Ndërtimi i parkut multifunksional në Novobërdë	502,492.90
20	Novoberde	Novobërdës	491,195.00
21	Partesh	Pastrimi i shtratit të lumit Morava e Binçes	497,742.00
22	Ranillug	Asfaltimi i rrugës Gornje Korminjane deri në rrugën kryesore Kamenicë-Gjilan	730,000.00
23	Ranillug	Konvikt për nxënësit e shkollave të mesme	460,000.00
24	Ranillug	Mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore	405,000.00
25	Ranillug	Qendra Sportive në Ranillug	780,000.00
26	Shterpce	Rehabilitimi i shtratit të lumit Miljoshtica	735,997.32
27	Viti	Efiçienca e Energjisë në Institucionet Shëndetësore Publike	428,973.82
28	Viti	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Viti	14,339,283.00
29	Viti	Ndërtimi i Teatrit të Qytetit në Komunën e Vitisë	615,130.00
30	Viti	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore Klllokot- Viti	3,108,490.00
31	Viti	Ndërtimi i rrjetit rrugor në komunën e Vitisë	3,379, 575.00
			66,033,108.07

Tabela 1.

MZHR ka dizajnuar kriteret për ndarjen e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) :

- Ndërtimi i objektit të trashëgimisë kulturore në Komunën e Deçanit, Shuma e paguar nga MZHR – 75,228.83 €, të zotuar për vitin 2023 – 340,248.19€.
- Asfaltimi i rrugës për tek stadiumi i qytetit me infrastrukturë përcjellëse në Komunën e Dragashit, Shuma e paguar nga MZHR - 140,000.00 €, të zotuar për vitin 2023 – 60,000€.
- Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklist në parkun e Kamenicës - Komuna e Drenasit, Shuma e paguar nga MZHR - 165,000.00 €,
- Ndërtimi i "Qendrës Edukative-Rekreative" Graçanicë, Shuma e paguar nga MZHR - 109,712.13€,
- Ndërtimi i ndriçimit rrugor në fshatin Vraboc dhe Mogill, Komuna Klllokot, Shuma e paguar nga MZHR - 54,923.56 €,
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Mamushë-Opterush, Komuna Malishevë, Shuma e paguar nga MZHR - 12,000.00 €,

- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Mamushë-Opterush, Shuma e paguar nga MZHR - 140,000.00 €,
- Ballkoni panoramik i qytetit dhe shtegu i ecjes, Shuma e paguar nga MZHR - 82,807,39€,
- Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë me ndriçim në komunën e Parteshit, Shuma e paguar nga MZHR - 70,000,00€,
- Ndërtimi i infrastrukturës për çiklizëm, Komuna Ranillugë, Shuma e paguar nga MZHR - 50,000,00€,
- Rregullimi i shtigjeve të ecjes, çiklizmit dhe ndriçimi publik në rrugën "Ferizaj" Komuna Shtime
- Shuma e paguar nga MZHR - 50,000,00€,
- Rregullimi natyral shtratit të lumit Klina me fshatrat Klinë e Poshtme - Kuqicë, Komuna Skenderaj.
- Shuma e paguar nga MZHR - 338,576,00€,
- Ndërtimi i mbikalimit - Hisar - lidhje e shtigjeve të ecjes në të dyja krahet e qytetit, Komuna Suharekë
- Shuma e paguar nga MZHR - 92,080.27.00€,
- Rehabilitimi i infrastrukturës në zonën e qendrës kulturore historike në fshatin Janjevë, Komuna Lipjan.
- Shuma e paguar nga MZHR - 120,000.00€,
- Ndërtimi i stacionit të autobusave, Komuna Podujevë.
- Shuma e paguar nga MZHR - 269,999.79€,

MAPL

MAPL për vitin 2023 ka realizuar 35 projekte nga programet si në vijim:

1. Nga programi "Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve të bazuar në performancën komunale" janë planifikuar për investime kapitale vlera prej 3,500,000.00 €, ndërsa është shpenzuar vlera prej 2,455,369.09 € ose 70.15%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:

- Vlerësimi i performancës së vitit 2021 për grantin e performancës komunale për vitin fiskal 2023

- Marrëveshjet për mbështetje financiare janë nënshkruar për komunat përfituese nga Granti i performancës me datën 14.03.2023,

- Zotimi i mjeteve është bërë me datën 04.05.2023 për shkak të zbatimit të ligjit me Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 konkretisht neni 14 - Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat.

Marrëveshja për mbështetje financiare përcaktojnë obligimet e palëve nënshkruese sipas nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

2. Nga programi "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" janë planifikuar për investime kapitale vlera prej 900,000.00 €, ndërsa është shpenzuar vlera prej 704,311.56 € ose 78.26%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:

- Thirrjen për aplikim ka qenë e hapur nga 25 prill 2023 deri 12 maj 2023,
- Marrëveshjet e për mbështetje financiare janë nënshkruar më 05.07.2023,
- Zotimi i mjeteve është bërë më 18.08.2023, për shkak të zbatimit të ligjit me Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 konkretisht neni 14 - Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat,
- Marrëveshja për mbështetje financiare ka përcaktuar obligimet e palëve nënshkruese sipas Nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

Nga programi "Mbështetja për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunitet e Republikës së Kosovës" janë planifikuar për investime kapitale vlera prej 800,000.00 € ndërsa është shpenzuar vlera prej 450,905.98 € ose 56.36%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:

- Thirrja për aplikime 25.04.2023 e hapur deri me 12.05.2023,
- Marrëveshjet për mbështetje financiare janë nënshkruar 29.06.2023, 03.07.2023 dhe 13.07.2023,
- Zotimi i mjeteve është bërë me datën 14.07.2023,
- Marrëveshja për mbështetje financiare ka përcaktuar obligimet e palëve nënshkruese, sipas nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

Veprimi - 2.1.3 Pasqyrimi sipas rajoneve zhvillimore të resurseve natyrore;
(*institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR*)

Pasqyrimi i resurseve natyrore është i planifikuar për realizim në vitin 2024, i cili është në proces të realizimit. Procesi i grumbullimit të dhënave nga akterët relevant ka filluar gjatë vitit 2023 me qëllim të hartimit të këtij dokumenti

Objektivi Specifik: 2.2 - Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Veprimi -2.2.1 Analiza e investimeve kapitale sipas rajoneve zhvillimore;
(*Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR*)

MZHR/Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale në vitin 2023, ka realizuar Analizën e Investimeve Kapitale për vitin 2022. Investimet kapitale nga niveli qendror në nivel lokal sipas 5 rajoneve zhvillimore. Në këtë analizë janë trajtuar, shpërndarja e balancuar, investimet kapitale për kokë banori, sektorët më të financuar²,

Veprimi -2.2.2. Analiza e shpërndarjes së granteve në sektorin privat nga niveli qendror në rajone;
(*Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MFT*)

² <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/C4BEB98B-06C7-4C65-B7A9-D3D4AF676492.pdf>

Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio - Ekonomike Rajonal, në vitin 2023 ka hartuar Analizën e Shpërndarjes së Granteve për Sektorin Privat (PZHRB) për vitin 2022, nga niveli qendron në 5 rajone zhvillimore. Është pasqyruar shpërndarja e balancuar e projekteve përfituese, identifikimi i pabarazive rajonale, pjesëmarrja e grave në projekte përfituese si dhe shpërndarja e granteve sipas përkatësisë etnike³

Veprimi -2.2.3 Hartimi dhe Implementimi i programit të zhvillimit rajonal me grante për komuna për përmirësimin e infrastrukturës publike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Janë dizajnuar kriteret për grante në infrastruktur publike, është hapur thirrja publike për aplikim,⁴

Është kontraktu Kompania mbikqyrëse për Monitorim dhe Raportim lidhur me implementimit e granteve në infrastrukturës publike, kontratë kjo që maban nr. 221-23-7561-2-2-1/c80 OE ky që vazhdimisht ka hartuar raportet periodike lidhur me implementimin e programit për zhvillim rajonal në përmirësimin e infrastrukturës publike.

MZHR në vitin 2023 gjithsej ka realizuar 21 projekte në 20 komuna të Republikës së Kosovës. Shuma e financuar për vitin 2023 ka qenë në vlerë 2,500,000.00 euro.

MZHR ka raportu këto Investime kapitale në pesë (5) rajone zhvillimore për vitin 2023:

1. *Rajoni Zhvillimor Qendër:* Podujeva, Drenasi, Shtime, Graçanicë, Lipjan.
2. *Rajoni Zhvillimor Veri:* Mitrovica e Jugut, Skenderaj,
3. *Rajoni Zhvillimor Perëndim:* Junik, Deçan.
4. *Rajoni Zhvillimor Jug:* Suhareka, Dragashi, Malishevë, Mamushë.
5. *Rajoni Zhvillimor Lindje:* Gjilan, Viti, Kllokot. Ranillug, Partesh,

Veprimi -2.2.4 Hartimi dhe Implementimi i programit për zhvillim rajonal të balancuar me grante në sektorin privat;


(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Janë dizajnuar kriteret për grante në sektorin privat, është hapur thirrja publike për aplikim⁵, janë krijuar ekipet monitoruese për monitorim dhe raportim lidhur me implementimit e granteve për biznese në sektorin privat, janë hartuar raportet periodike lidhur me implementimin e programit për zhvillim rajonal në sektorin privat.

³ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/2913F292-BF8B-41A5-9C21-B54682371580.pdf>

⁴ <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,35,2023,1073>

Në vitin 2023 nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (Përkrahja e bizneseve PZHRB 2022): nga 1845 Projekt Propozime që kanë aplikuar , janë nënshkruar kontratat me MZHR-në 131 Projekt Propozime. Mjete e destinuar për këtë thirrje kanë qenë në shumën prej: 1,500.000.00€.



Objektiv Specifik: 2.3 - Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

*Veprimi -2.3.1 Hartimi i politikave për zhvillim të balancuar rajonal;
(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)*

Është miratuar Plani i veprimit 2023-2025 i Strategjisë për Zhvillim rajonal 2020-30.

Janë themeluar Grupet Punuese për hartimin e analizave. Janë përfuduar dhe publikuar një numër i konsiderueshëm i analizave dhe dokumenteve që mbulojnë fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal:

- Analiza për Investime Kapitale sipas rajoneve zhvillimore për vitin 2022⁶;
- Analiza Socio - ekonomike rajonale e balancuar (përkrahja e sektorit privat) 2022 dhe për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve fillestare (PZHRB-Start UP), për periudhën 2019-2022⁷.
- Është hartuar dhe publikuar Analiza e Investimeve Kapitale sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë 2018 – 2020⁸:

⁶ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/2913F292-BF8B-41A5-9C21-B54682371580.pdf>

⁷ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/C4BEB98B-06C7-4C65-B7A9-D3D4AF676492.pdf>

⁸ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/2D4DE660-80EB-440F-8C00-8E4584EE0928.pdf>

- Është hartuar dhe publikuar Analiza për përkrahje të sektorit privat 2018 – 2020⁹;
- Është hartuar dokumenti “Studimi i fizibilitetit “Zhvillimi rajonal i balancuar dhe disajnimi i sistemit për matjen e performancës rajonale”, si dhe është realizuar pilotimi në SPSS dhe ngritja e kapaciteteve të stafit për aplikimin e këtij programi¹⁰;
- Përfundimi i Dokumentit shpjegues për kriteret e brendimit të rajoneve zhvillimore¹¹;
- Përfundimi i Analizës së Granteve i avansuar me institucionet shtesë 2021¹²;
- Përfundimi i Analizës së Investimeve Kapitale 2021¹³;
- Përfundimi i Dokumentit Avnaci i Zhvillimit Rajonal 2017-21¹⁴;
- Raporti për Funksonimin e zonave ekonomike 2021¹⁵;
- Përfundimi i dokumentit “pasqyrimi i inventarizimit të resurseve kulturore sipas rajoneve zhvillimore”;¹⁶

¹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/7DF1223F-423E-4380-BEE5-614977121AD1.pdf>

¹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/A64F86A1-E70E-4946-B88B-833DCFFA9CC0.pdf>

¹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/A64F86A1-E70E-4946-B88B-833DCFFA9CC0.pdf>

¹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/613D817F-05AC-4F67-ADB1-66440637B912.pdf>

¹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/4BA2647E-6CFC-4F0A-B991-54BA35B831E7.pdf>

¹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/F7064850-9D11-4CCE-8EED-BE825D58BDDF.pdf>; <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/7AE044FF-4743-4E32-AB90-9A6AD6103D7E.pdf>; <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/765F4AAA-BC65-4FC7-87E3-DDD3E58B5924.pdf>

Veprimi -2.3.2 Zhvillimi i programit për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve socio-ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MINT)

Nuk ka aktivitete që kanë qenë të planifikuara për v.2023.

⁹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/CEC9D480-0307-4BAC-9250-34A6451147F6.pdf>

¹⁰ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/269669BF-3EA6-4F59-9864-A5B3A4AC82DE.pdf>

Objektivi Specifik: 2.4 - Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonat përmes programeve trans nacionale;

Veprimi -2.4.1 Përgatitja e plan programit për anëtarësim dhe kërkesa për anëtarësim ne programet: BALKANMED, ADRION dhe DANUB;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MPJD)

Kosova ka aplikuar në qershorin e vitit 2022 për tu bërë pjesë e programeve trans-nacionale Euro-MED, Adrion dhe Danub, apo thënë ndryshe kemi aplikuar tek autoritetet menaxhuese të programeve në fjalë.

Fillimisht, mund të themi se përfshirja e Kosovës në Programin Trans-nacional : INTERREG Danub, Adrion si dhe Euro-Med mund t'i sjellë përfitime vendit tonë, dhe qytetarëve tanë përmes fushave tematike që programet i adresojnë përmes katër kategorive: Zhvillimi i strategjive të përbashkëta/planeve të veprimit; Zhvillimi i zgjidhjeve praktike, të harmonizuara, të përbashkëta; Zbatimi i veprimeve pilot që testojnë ose demonstrojnë zbatueshmërinë praktike dhe qëndrueshmërinë e zgjidhjeve të zhvilluara bashkërisht në kuadër të projekteve, si dhe zbatimin e veprimeve për ngritjen e kapaciteteve në dobi të institucioneve, organizatave të përfshira në projekte. Nëpërmjet këtyre kategorive tematike Kosova mund të përfitojë në aspektin ekonomik, social, kulturor, arsimor, kulturor. Përpjekja e Kosovës për anëtarësim në programet trans-nacionale Danub, Adrion, Euro-MED, apo ndonjë program tjetër të ngjashëm do vazhdojë edhe më tej, pasi që aktualisht ende nuk jemi pjesë për arsyeje politike.

Veprimi -2.4.2. Përgatitja e planit të bashkëpunimit me sekretariatet e programeve trans nacionale: BALKANMED, ADRION dhe DANUB;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Para së gjithash duhet cekur se përfshirja e Kosovës në Programet Trans-nacionale : INTERREG Danub, Adrion si dhe Euro-Med mund t'i sjelli përfitime vendit dhe qytetarëve tanë qindra, mijëra apo edhe miliona euro, përmes fushave tematike që ndërliken me aspektet, si : Inovacionet, Lidhshmëria; Mjedisi dhe Qeverisja e Mirë, Transporti, si dhe Zhvillimi Lokal e Regjional.

Përfitues të programit mund të jenë organet/institucionet publike lokale, rajonale dhe kombëtare, organizatat joqeveritare, grupet evropiane të bashkëpunimit territorial (EGTC).

Ma tej, do sqarojmë për fushat dhe buxhetin e secilit program trans-nacional, ku Kosova ka aplikuar në Qershor të viti 2022, për tu bërë vend anëtar me status të vëshguesit.

-Programi Interreg Danub -

Programi Interreg i Rajonit të Danubit - (2021-2027) është një Program Evropian i Bashkëpunimit Trans nacional për të promovuar ndarjen dhe zbatimin e zgjidhjeve të përbashkëta për të adresuar sfidat dhe problemet e përbashkëta në Rajonin e Danubit, duke i afruar kështu vendet dhe rajonet pjesëmarrëse. Të gjitha sfidat e identifikuar nga analiza territoriale e programit janë në përputhje me planin e veprimit të Strategjisë së BE-së për Rajonin e Danubit (EUSDR). Prandaj, prioritetet e programit, përkatësisht: Inovacionet, Lidhshmëria; Mjedisi dhe Qeverisja e Mirë, përkohë me ato të Strategjisë së Danubit.

Buxheti i përgjithshëm i BE-së i Programit të Rajonit të Danubit për periudhën 2021-2027 është 215,047,857 EUR (165,424,228 EUR nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF), 30,000,000 EUR nga Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit (IPA2,196, EUR32,196) , Instrumenti i Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (NDICI).

Përfitues të programit mund të jenë organet/institucionet publike lokale, rajonale dhe kombëtare, organizatat joqeveritare, grupet evropiane të bashkëpunimit territorial (EGTC).

-Programi Adrion Jonian - është një program evropian trans-nacional që investon në sistemet rajonale të inovacionit, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, elasticitetin mjedisor, transportin dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme si dhe ndërtimin e kapaciteteve. Duke bashkuar shtetet anëtare të BE-së dhe atyre jo anëtare, ADRION synon të veprojë si një shtytës politikash dhe novator i qeverisjes për të mirën e më shumë se 70 milionë njerëzve në rajonin e Adriatikut dhe Jonit. Duke qenë se programi bashkëpunimi trans-nacional, ADRION kontribuon në Bashkëpunimin Territorial Evropian, i cili është një nga qëllimet e politikës së kohezionit të BE-së, e cila synon të promovojë një zhvillim harmonik ekonomik, social dhe territorial të Bashkimit Evropian në tërësi dhe ofron një kornizë për zbatimin e veprimeve të përbashkëta dhe shkëmbimi i politikave ndërmjet aktorëve kombëtarë, rajonalë dhe lokalë nga shtete të ndryshme anëtare.

-Programi Interreg Euro-MED -

Programi Interreg Euro-MED është a bëjë rajonin e Mesdheut më të zgjuar dhe më të gjelbër dhe të përmirësues qeverisjen midis palëve të tij të interesuara. Ne ofrojmë fonde për projekte të zhvilluara dhe të menaxhuara nga administrata publike, universitete, organizata private dhe të shoqërisë civile.

Programi Interreg Euro-MED mbështet bashkëpunimin përtej kufijve mesdhetar si dhe ofron fonde për projekte të zhvilluara dhe të menaxhuara nga administrata publike, universitete, organizata private dhe të shoqërisë civile.

Programi bashkon partnerë nga 69 rajone të 14 vendeve nga bregu verior i Mesdheut me një objektiv të përbashkët: një shoqëri klimatike neutrale dhe elastike për të mirën e qytetarëve të saj.

Për shtatë vitet e ardhshme 2021-2027, së bashku me partnerët tanë do të punojmë për ta bërë rajonin më të zgjuar, më të gjelbër dhe për të përmirësuar qeverisjen midis palëve të tij të interesit. Buxheti i përgjithshëm i programit arrin në rreth 294 milion € për periudhën 2021-2027.

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 3. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM RAJONAL BAZUAR NË RESURSE NATYRORE, EKONOMIKE, KULTURORE DHE HUMANE

Objektivi specifik- 3.1 - Resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe te promovuara;

Veprimi - 3.1.1 Krijimi i data bazës për Inventarizimin e resurseve natyrore, ekonomike dhe kulturore sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MINT)

MZHR respektivisht DPASER ka krijuar dokumentin sipas pesë rajoneve zhvillimore me të gjitha të dhënat nga lista e trashëgimisë kulturore dhe listat e objekteve kulturore (të dhëna primare të pranuar nga (MKRS). Gjithashtu është hartuar edhe dokumenti për resurset ekonomike, ndërkaq është në proces të harimit dokumenti për resurset natyrore.¹⁷

Veprimi - 3.1.2. Krijimi i data bazës për identifikimin e burimeve njerëzore sipas profileve profesionale sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ASK, MFPT ministritëe Linjës dhe donatorët)

Gjate vitit 2023 nuk jane ndermarre veprime per realizimin e kesaj mase dhe nje gje e tille eshte planifikuar per vitin 2024 pasi te jete perfunduar regjistrimi i popullesise me qellim qe te dhenat te jene sa me relevante.

¹⁷ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/CEC9D480-0307-4BAC-9250-34A6451147F6.pdf>

Objektivi Specifik: 3.2- Ndërtimi i kapaciteteve humane dhe OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal;

Veprimi - 3.2.1 Ngritja e kapaciteteve humane të nivelit lokal për shfrytëzimin e resurseve natyrore, përmes përkrahjes financiare;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes Thirrjes Publike¹⁸ që realizon çdo vit për mbështetjen financiare të projekteve/ programeve të QJQ-ve për avancimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar ka mbështetur Organizata Joqeveritare të udhëhequra nga gratë edhe të rinjët, me një numër të mirë të projekteve. Në total janë financuar 44 projekte për vitin 2023 me vlerë 182,000.00 euro.

Rajoni Zhvillimor Qendër

Gjatë vitit 2023, Agjencia për Zhvillim Rajonal Qendër ka implementuar projektin "Rajoni Ekonomik Qendër me ambient më të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrësisë ", financuar nga MZHR.

Gjatë asaj kohe është mbajtur trajnimi i 20 zyrtarëve komunal nga tetë (8) komunat e rajonit qendër për pesë (5) ditë radhazi lidhur me "Rajoni Ekonomik Qendër me ambient më të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrësisë", përmes trajnimit për "*Planifikim strategjik për krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrësisë*"

- Punëtori me zyrtarë komunal në përgatitjen e projekt koncepteve komunale dhe rajonale lidhur me programin e lansuar nga MZHR për komunat.
- Organizimi i punëtorisë së bashku me MZHR-në dhe komunat e RQ lidhur me përgatitjet e Konferencës së Donatorëve e cila është planifikuar të mbahet në qershor të vitit 2023.
- Organizimi i sesioneve informuese në komuna lidhur me skemën e granteve për biznese dhe start up të lansuar nga MZHR.
- Organizime dhe takime me Kryetar e Drejtor të komunave nga Rajoni Qendër së bashku me MZHR-në, për t'i njoftuar më hollësisht rreth mundësisë së aplikimit në fondet e Komisionit Evropian.

Rajoni Zhvillimor Lindje

Ne vitin 2023 AZHR Lindje ka implementuar projektin "' Promovimi i zhvillimit rajonal dhe Agjendës së gjelbër në rajonin Lindje", financuar nga MZHR. - Qellimi i këtij projekti ka qene promovimi i politikave te MZHR-se ne perkrhaje te komunave dhe bizneseve ne

¹⁸ <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,37,2023,1024>

nivel te vendit e me fokus te veqante ne rajonin ekonomik lindje. Rezultate te projektit kane qene: 1. Realizimi i nje video promovuese me 4 biznese perfituese te granteve te MZHR si dhe 3 kryetare te komunave perfitues te PZHRB Investime kapitale, dhe 2. Organizimi i tryezes se rrumbullaket rajonale "Roli i nivelit lokal ne promovimin e Agjendës së gjelbër" ku kane marre pjese 44 pjesemarres nga komunat e rajonit Lindje.

Rajoni Zhvillimor Perëndim

Gjatë vitit 2023, AZHR-Perëndim si pjesë e aktiviteteve të projektit "Promovimi i politikave kombëtare të zhvillimit rajonal të balansuar në komunat e rajonit perëndimorë të Kosovës", të financuar nga ana e MZHR, ka realizuar në bashkëpunim me MZHR një vizitë studimore në Slloveni me grupin parlamentar të Kuvendit të Kosovës. Ministri dhe Sekretari i MZHR së bashku me stafin, dhe anëtarët përkatës të Parlamentit të Kosovës, si dhe përfaqësuesi i AZHR-Perëndim dhe rrjetit të AZHR-ve, nga takimet me Ministrin e Kohezionit në qeverinë e Sllovenisë, komisionin parlamentar përgjegjës për zhvillim rajonal, si dhe përfaqësues të AZHR-ve arritën të kuptojnë mbarëvajtjen e këtij procesi në Slloveni, si dhe të përfitojnë nga përvoja e këtij vendi në këtë fushë përkatëse. Nga vizita studimore u nxorën konkluzione dhe rekomandime mbi politikat dhe programet zhvillimore të Sllovenisë, si dhe praktikave të tyre të mira. Kjo vizitë studimore i shërbeu kryesisht Grupit Parlamentar si mjet krahasues i dispozitave të draft ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar në Kosovë me ato të vendeve të BE-së, si dhe praktikave të BE-së në mbështetjen e zhvillimit rajonal në shtetet përkatëse, gjatë kohës kur ky draft ligj ishte akoma në proces të miratimit nga Kuvendi i Kosovës.

1. Gjatë vitit 2023, AZHR-Perëndim ka zbatuar projektin "Promovimi i politikave kombëtare të zhvillimit rajonal të balansuar në komunat e rajonit perëndimorë të Kosovës", të financuar nga ana e MZHR. Përmes këtij projekti janë realizuar takime të tri grupeve punuese të ndryshme, të themeluara për qëllime të këtij projekti, anëtarë të së cilave kanë qenë përfaqësues komunal nga gjashtë Komunitet e rajonit perëndimorë. Grupet punuese të themeluara kanë qenë si në vijim: i. GP për Arsim Profesional dhe Ndërmarrësi; GP për Trashëgimi Kulturor dhe Promovim Rajonal; dhe GP për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm. Përfundimisht, puna e këtyre tri grupeve punuese iu paraqit përfaqësuesve të MZHR-së dhe Kryetarëve të Komunave me datën 3 nëntor 2023, në formën e një raporti përmbledhës, i cili përmban 207 projekte me shtrirje komunale dhe ndër-komunale, si dhe 14 projekte rajonale, nga fushat e zhvillimit ekonomik, turizmit të qëndrueshëm, arsimit profesional dhe ndërmarrësisë, trashëgimisë kulturore dhe promovimit rajonal.

2. Gjatë vitit 2023, AZHR-Perëndim ka filluar zbatimin e projektit "Shndrimi i fshatrave tona në destinacione turistike" të financuar nga BE-ja përmes programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë-Mali i Zi, ku së bashku me Komunitetin e Pejës dhe partnerë nga Mali i

Zi është duke zbatuar aktivitete për zhvillimin e turizmit rural në këtë rajon, përmes këtij projekti dy vjeçar. AZHR-Perëndim është gjithashtu duke dhenë mbështetje në realizimin e projekteve tjera nga po i njëjti program i bashkëpunimit ndërkuftarë, të cilat kanë shtrirje në Komunitat e tjera të rajonit.

3. Gjatë vitit 2023, AZHR-Perëndim ka vazhduar me zbatimin e aktiviteteve nga projekti "PPSE", në bashkëpunim me organizatën Swiss Contact, lidhur me mbështetjen e bizneseve të rajonit perëndimorë në zhvillimin e kapaciteteve për marketing digjital. Në bashkëpunim me Komunitat e rajonit, përkatësisht Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik, janë identifikuar dhe mbështetur 20 biznese në këtë fushë, kryesisht ato të udhëhequra nga gratë, në fusha si përpunim i ushqimeve, produkteve artizanale, si dhe turizëm dhe hoteleri.

Rajoni Zhvillimor Veri

Ne vitin 2022, AZHR Veri ka implementuar projektin "Zhvillim rajonal i balancuar – Rajoni Veri i aftë për konkurrencë ndër-rajonale" • 24 kontrata të bizneseve të Parkut të Biznesit në Mitrovicë Jugore të nënshkruara

- Bordi i Parkut të Biznesit në Mitrovicë funksional
- Draft modelet e kontratave për Zonën Industriale në Lumadh, Vushtrri të pregaditura
- Vizitat studimore në Mitrovicë (e organizuar)
- Plani i Veprimt për Strategjinë e Turizmit të Skenderaj i Finalizuar dhe aprovuar.

Rajoni Zhvillimor Jug - Projekti i realizuar nga ana jonë ishte: „Hulumtimi dhe promovimi i politikave të fushës së zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar të formatit të BE, si dhe avancimi i zhvillimit rajonal përmes tryezave të rrumbullakëta dhe formave tjera të marketingut social”.

Pjesëmarrës në aktivitetet e projektit ishin si më poshtë:

1. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në aktivitetin / aktivitetet e organizuara nga ne ishte 41.
2. Numri i te rinjve pjesëmarrës: N/A
3. Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë ishte: 33 Meshkuj dhe 8 Femra.

Veprimi - 3.2.2 Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve tek të rinjtë për identifikimin e mundësive të vetëpunësimit dhe krijimin e bizneseve "start up";

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Përmes programit për Mbështetje të Organizatave të Shoqërosë Civile (OSHC) janë zhvilluar 64 aktivitete nga 44 OJQ-të përfituese për mundësitë e vetpunësimit ku pjesë kanë përfituar rreth 350 pjesëmarrës me trajnime me temë ngritja e kapaciteteve të grave dhe të rinjëve.

Objektiv Specifik: 3.3 - Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi - 3.3.1 Ndarja e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

MZHR ka dizajnuar kriteret për ndarjen e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike si në vijim:

- Ndërtimi i Urës që lidh Komunën e Junikut me Eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq, Komuna Junik. Shuma e paguar nga MZHR - 70,000.00 €, kjo zonë quhet zonë turitike për faktin se fshatrat Jasiq dhe Gjocaj njihen si ekofshatra. Ndërsa Komuna e Junikut nga buxheti i saj vjetor i vitit 2023, financon këtë projekt në shumën prej 52,174.50 euro.
- Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes ka vlerën para llogaritare prej 340,000.00 euro, MZHR nga buxheti i saj vjetor i vitit 2022, financon këtë projekt në shumën 150,000 euro, MZHR këtë projekt ka mbështetur në vitin 2023 në shumën prej 150,000.00 euro.
- Projekti i rinovimit të objektit për inkubator biznesi, Komuna Viti ka vlerën para llogaritare prej 494,253 euro, MZHR gjatë vitit 2022 ka financuar në shumën 140,000 euro ndërsa Komuna e Vitis 40,000 euro, MZHR gjatë vitit 2023 ka mbështetur në shumën prej 250,000 euro nga Komuna e Vitisë 64,253 euro.

Veprimi - 3.3.2 - Ndarja e granteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve në zonat ekonomike me theks të veçantë për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

MZHR ka ndërmarrë veprime konkrete përmes thirrjes publike, organizimit të 5 sesioneve informuese për promovim të formave të bashkëpunimit për zhvillimin socio-ekonomik. (MZHR).

Në vitin 2023, ka përzgjedhë 131 përfitues dhe janë implementuar 131 projekte nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, në vlerë prej 2,000.000.00€, prej të cilave 69 përfitues janë në fushën e prodhimit!

Veprimi - 3.3.3 Promovimi i politikave rajonale dhe kushteve të cilat ofrohen për tërheqjen e investitorëve të huaj në rajone zhvillimore;

(Institucioni përgjegjës sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Gjatë vitit 2024 do të hartohet Udhëzues për studimin e fizibilitetit në rajone zhvillimore për identifikimin e investimeve strategjike me ndikim socio - ekonomik rajonal dhe Udhëzues për brendimin e rajoneve zhvillimore. Janë formuar grupet punuese për hartimin e dy udhëzuesve, në të cilin do të përshkruhet metodologjia, objektivat dhe hapat tjerë të nevojshëm për procesin e realizimit të këtyre dokumenteve me rëndësi strategjike për rajonet zhvillimore.

Veprimi - 3.3.4 Analizimi i investimeve nga niveli qendror në zonat ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Krijimi i Grupit Punues. DPASER gjatë vitit 2022, ka avancuar edhe me tej në bashkëpunim me MINT raportin për funksionalizimin e zonave ekonomike. Raporti identifikon gjitha zonat ekonomike funksionale dhe ato jo funksionale, numëri i bizneseve që operojnë, veprimtaritë, punësimin, identifikimin e tyre në hartat kadastrale. MZHR përmes programeve të saj, PZHRB dhe PZHR mbështet bizneset që operojnë në zona ekonomike dhe mbështet komunat të cilat aplikojnë me projekte në mbështetje të infrastrukturës në zonat ekonomike. Raporti është konsultuar me MINT dhe komunat përgjegjëse dhe gjendet i publikuar në uef faqen zyrtare të MZHR-së.

Sipas analizës MZHR ka mbështet keto biznese¹⁹

¹⁹ <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/A64F86A1-E70E-4946-B88B-833DCFFA9CC0.pdf>

**VLERËSIM I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME TË ARRITURAT DHE REZULTATET
PËR IMPLEMENTIM TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM RAJONAL PËR VITIN 2023**

Sfidat e implementimit gjatë vitit 2023 kanë qenë:

- Përgatitja e analizës krahasimore për praktikat e zhvillimit rajonal në vendet e rajonit dhe vendet e BE-së;
- Aprovimi i Ligjit për zhvillim rajonal te balancuar;
- Finalizimi i drafteve të 2 Rregulloreve të cilat derivojnë nga Ligji për Zhvillim Rajonal;
- Krijimi i mekanizmit monitories për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal;
- Zbatimi i tri programeve zhvillimore të MZHR-së për vitin 2023

Sfidat e dala për vitin 2024:

- Zbatimi i Ligjit për zhvillim rajonal te balancuar;
- Aprovimi i drafteve të 4 Rregulloreve të cilat derivojnë nga Ligji për Zhvillim Rajonal;

Më poshtë gjeni tabelën ku është vendosur buxheti që është shpenzuar gjatë vitit 2023:

1. Lansimi dhe zbatimi i Programit për Zhvillim Rajonal (kategoria e investimeve kapitale për Komuna) për periudhën 2023-2024:

Përshkrimi	Nr i Aplikimeve	Buxheti ne dispozicion	Nr i Projekteve te financuara	Vlera totale e fiancimit
PZHR 2023	44	2,000,000.00	20 komuna 21 projekte	2,500,000.00
PZHR 2024	51	4,000,000.00	Në proces	

2. Lansimi dhe zbatimi i Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (Përkrahja e bizneseve PZHRB) PZHRB 2023-2024:

Përshkrimi	Nr i Aplikimeve	Buxheti ne dispozicion	Nr i Projekteve te financuara	Vlera totale e fiancimit
PZHRB 2023	1845	2,000,000.00	132 projekte	1,500.000.00
PZHRB 2024	Në proces	2,000,000.00		

3. Lansimi dhe zbatimi i programit me OSHC 2023-2024

Përshkrimi	Nr i Aplikimeve	Buxheti ne dispozicion	Nr i Projekteve te financuara	Vlera totale e fiancimit
OSCH 2023	114	180,000.00	44 projekte	182,000.00
OSCH 2024	Në proces	200,000.00	Në proces	